

KAPITULLI 3

DIVERSITETI DHE PLURALIZMI

Arsimi i mesëm

Pëlqimin përmes mospajtimit?

Si mund të biem dakord për të mirën e përbashkët?

"La multitude qui ne se réduit pas à l'unité est confusion; l'unité qui ne dépend pas de la multitude est tyrannie."

[Diversiteti që nuk mund të çojë në unitet është konfuzion;

uniteti që shpërfill shumëllojshmërinë është tirani.]

Blaise Pascal (1623-1662)

3.1 Po të isha president ...

Nxënësit përcaktojnë përparësitë e tyre politike

3.2 Çfarë qëllimesh duam të promovojmë?

Nxënësit formojnë parti politike

3.3 Çfarë është e mira e përbashkët?

Pëlqimi përmes mospajtimit

3.4 Pjesëmarrja në demokracinë pluraliste

Nxënësit reflektojnë për përvojën e tyre

Kapitulli 3

Diversiteti dhe pluralizmi

Pëlqimi përmes mospajtit?

Hyrje për mësuesit

1. Lidhjet midis shumëllojshmërisë, pluralizmit dhe demokracisë

Diversiteti - disa shembuj

- Punëtorët dhe punëdhënësit debatojnë në lidhje me pagat dhe orët e punës.
- Ambientalistët debatojnë me lobin e shoferëve të kamionëve rreth planeve për një rrugë të re.
- Prindërit duan më shumë mësues që të merren me nevojat e fëmijëve të tyre. Një lob i tatimpaguesve dëshiron reduktim të taksave.
- Mjekët dhe jo-duhanpirësit duan një ndalim të plotë të pirjes së duhanit në bare dhe restorante. Pronarët dhe cigareprodhuesit nxisin pirjen e lirë të duhanit kudo.
- Të rinjtë dëshirojnë një ndërtesë bosh që të shndërrohet në një qendër rinore. Banorët aty pranë kanë frikë se do të ketë shumë zhurmë natën.

Koncepti i **diversitetit** lidhet me mënyrën në të cilat njerëzit ndryshojnë - në interesat e tyre, por edhe në shumë mënyra të tjera: në stilin e tyre të jetesës, prejardhjen etnike, besimet dhe vlerat, në statusin social, gjininë, brezin, dialektin dhe rajonin (për shembull, urban apo rural). Edhe diversiteti rritet në funksion të ndryshimeve sociale dhe ekonomike.

A është diversiteti një problem?

Sipas teorive të **pluralizmit**, përgjigja është jo. Në sistemet demokratike, kushdo që promovon interesat individuale ose të grupit ushtron të drejtat e njeriut - për shembull, demonstrimi në publik është të ushtruarit e lirisë së shprehjes. Koncepti i pluralizmit, pra pranon diversitetin - ky është një fakt, diçka "normale". Megjithatë, ai paraqet një sfidë. Si mund të pajtohen interesat e ndryshme midis grupeve dhe individëve të ndryshëm? Cila është zgjidhja më e mirë për konfliktet dhe problemet që ata artikulojnë? Kjo është çështja e së **mirës së përbashkët**.

Çfarë është e mira e përbashkët?

Sipas teorive të pluralizmit, askush nuk e di se çfarë është e mirë e përbashkët para se të zhvillohet një diskutim publik për këtë çështje. Ne duhet të biem dakord për atë që na shërben më mirë. E mira e përbashkët është diçka që duhet të negociohet. Le të shikojmë në dy shembujt e mësipërm.

- Punëtorët dhe punëdhënësit e tyre duhet të bien dakord për një pagë që u jep punëtorëve një standard të denjë jetese dhe i lejon punëdhënësit të mbajnë shpenzimet nën kontroll.
- Çështja për qendrën rinore mund të zgjidhet me ndërtimin e qendrës, por duke vendosur rregulla në mënyrë që të mbrohen fqinjët nga zhurma e tepërt. Zgjidhja më e mirë duhet të gjendet përmes dialogut dhe negociatave, dhe rezultati është shpesh një kompromis.

Prandaj, pluralizmi është i lidhur me një koncept konstruktivist të së mirës së përbashkët. Së pari, të gjithë lojtarët artikulojnë interesat e tyre të ndryshme, pastaj shikojnë për një zgjidhje që të mund ta pranojnë të gjithë. Prandaj nuk ka asgjë "egoiste" në lidhje me shprehjen në mënyrë të qartë të interesave të dikujt. Përkundrazi, kjo është pjesë e procesit, por askush nuk duhet të presë që të shohë të gjithë interesat e tyre të përmbushura plotësisht. Koncepti i konstruktivizmit thekson se këtu përfshihet edhe një element i të mësuarit, që ndjek modelin e provës dhe të gabimit.

Praktika do të tregojë sa e mirë është një zgjidhje dhe ajo mund të duhet të ndryshohet ose të përmirësohet në një raund të ri të diskutimesh dhe negociatash.

Në çfarë mënyre është pluralizmi i lidhur me demokracinë?

Pluralizmi është një formë e konkurrencës. Lojtarët konkurrojnë me njëri-tjetrin për të promovuar interesat e tyre dhe negociatat përfshijnë të dyja, si pushtetin edhe arsyetimin. Kjo lloj konkurrence, në të njëjtën kohë, siguron se asnjë lojtar në fushë nuk bëhet dominues. Diversiteti dhe pluralizmi krijojnë një strukturë të *polyarchy* (pushtetit në duart e shumicës), e cila është ekuivalenti social i parimit të kontrollit dhe balancimit në një kushtetutë demokratike. Pluralizmi bazohet në liberalizëm duke zgjeruar konkurrencën nga ekonomia në shoqëri dhe në politikë.

Si e menaxhon pluralizmi zgjidhjen e konflikteve të interesit në mënyrë paqësore?

Diversiteti dhe pluralizmi lejojnë një pjesë të madhe të mospajtimit për interesat dhe problemet (një "sferë e mospajtimit"). Kjo do të veprojë vetëm në se ekziston një "sferë e marrëveshjeve". Pluralizmi kërkon që qytetarët të bien dakord për disa vlera dhe rregullat bazë:

- Njohja reciproke: lojtarët e tjerë shihen si kundërshtarë, por jo si armiq.
- Jo-dhunë: negociatat zhvillohen me mjete paqësore, që është me fjalë dhe jo me forcë fizike.
- Pranimi i kompromisit: të gjithë lojtarët kuptojnë dhe pranojnë se një vendim mund të arrihet vetëm nëpërmjet kompromisit.
- Sundimi i shumicës: në qoftë se një vendim votohet, shumica vendos.
- Gjykimi dhe gabimi: nëse kushtet ndryshojnë, ose një vendim provohet gabim, zhvillohen negociata të reja.
- Drejtësia: vendimet duhet të jenë në përputhje me të drejtat e njeriut.

Kritika e konceptit të pluralizmit

Kritikët kanë theksuar se në modelin pluralist, ka pushtet në duart e shumicës, por për shkak të diversitetit, ai është i shpërndarë në mënyrë të pabarabartë. Prandaj, disa lojtarë kanë shanse më të mira në konkurrencën e interesave se të tjerët.

Ky argument thekson një tension kushtetues midis lirisë dhe barazisë - është kushtetues, që do të thotë se është i pamundur të çrrënjohet, si për demokracinë edhe për të drejtat e njeriut. Pluralistët promovojnë të kuptuarit liberal të demokracisë konkurruese, kritikët këmbëngulin në leximin barazimtar të demokracisë.

Brenda modelit pluralist, tensioni midis lirisë dhe barazisë është thelbi i çështjes së të mirës së përbashkët. Liri do të thotë konkurrencë dhe konkurrenca prodhon fitues dhe humbës, dmth, pabarazinë. Pra, kur të vendoset për të mirën e përbashkët, lojtarët e përfshirë duhet të marrin parasysh nevojat e të dobët.

A ka një alternativë të pluralizmit?

Refuzimi i pluralizmit nënkupton dorëzimin para "tundimit autoritar". E mira e përbashkët është përcaktuar nga një autoritet dhe kushdo që nuk pajtohet me të shtypet si armik. Partitë komuniste janë një shembull i tillë. Ato pohuan udhëheqjen e vetme në bazë të të qenit në gjendje të përcaktonin të mirën e përbashkët me mjete shkencore. Si demokracia liberale dhe ajo barazimtare u refuzuan.

Në fund të fundit, alternativa e demokracisë pluraliste është një formë e diktaturës. Kjo reflektohet në komentin e Winston Churchill-it se "demokracia është forma më e keqe e qeverisjes, përveç gjithë atyre të tjerave që janë provuar". Demokracia pluraliste nuk është pa rreziqe, por duket se është forma më e mirë e qeverisjes për të trajtuar diversitetin ndërmjet anëtarëve të saj në mënyrë paqësore.

2 Pjesëmarrja në demokraci - çfarë mundëson ky kapitull

Nxënësit mësojnë se ata janë pjesëmarrës në një **demokraci pluraliste**:

- Ata duhet të bëjnë veten që të dëgjohen, nëse duan që interesat dhe idetë e tyre të merren parasysh; pjesëmarrje në demokraci do të thotë gjithashtu pjesëmarrje në garën e pluralizmit.
- Pjesëmarrja në demokraci do të thotë negociata për të mirën e përbashkët.
- Pjesëmarrja në demokraci kërkon që të gjithë lojtarët të pranojnë vlerat themelore të njohjes së ndërsjellë, të jo-dhunës, të gatishmërisë për kompromis dhe të sundimit të shumicës.

Kapitulli e zbaton metodën e të mësuarit në bazë të detyrave. Nxënësit kuptojnë shumëllojshmërinë duke e përjetuar atë në klasë; pluralizmin e kuptojnë duke u përfshirë në mënyrë aktive në procesin e negociatave për të mirën e përbashkët

Mësimi 1: së pari, nga nxënësit kërkohet që të ndajnë idetë për atë që do të kenë në krye të agjendës së tyre, nëse do të ishin president ose kryeministër i qeverisë në vendin e tyre. Nxënësit do të përjetojnë se ekziston diversiteti i mendimeve dhe ideve mes tyre. Klasa është një model i diversitetit në shoqëri si një e tërë.

Mësimet 2 dhe 3: më tej fillon procesi i negociatave. Nxënësit, të cilët ndajnë një opinion të caktuar ose trajtim të ngjashëm themelor, formojnë parti politike (grupet e llojeve të tjera lihen jashtë këtij modeli); të tjerët mund të zgjedhin të qëndrojnë të vetëm. Nxënësit përcaktojnë qëllimet dhe përparësitë e tyre dhe pastaj negociojnë. Ata mund ose mund të mos arrijnë të gjithë në një vendim ose kompromis, por të paktën shumica, mund të bien dakord - si në realitet. Ata do të përjetojnë përparësitë e organizatave, të tilla si partitë, për individët në konkurimin, për vendosjen e agjendës së ditës dhe për përcaktimin e zgjidhjeve.

Mësimi 4: nxënësit reflektojnë për përvojën e tyre dhe japin vlerësimet për kapitullin.

Roli i mësuesit është ai i një ndihmësi. Nxënësit e zhvillojnë kapitullin përmes aktiviteteve të tyre. Disa të dhëna të shkurtra nga mësuesit sugjerohen për të mbështetur të mësuarit konstruktivist nga nxënësit, përmes udhëzimit për konceptet kyçe. Mësuesi i mundëson këto të dhëna kur nxënësit janë të gatshëm për to. Fletët e punës së nxënësit dhe materialet për mësuesit sigurojnë burimet dhe informacionin e nevojshëm.

Zhvillim kompetencash: lidhja me kapitujt e tjerë në këtë vëllim

Çfarë tregon kjo tabelë

Titulli i këtij manuali, *Pjesëmarrja në demokraci*, përqendrohet në kompetencat e qytetarit aktiv në demokraci. Kjo matricë tregon potencialin e pasojave të sinergjisë midis kapitujve të këtij manuali. Matrica tregon se çfarë kompetenca janë zhvilluar në kapitullin 3 (rreshtat e theksuar në tabelë). Kolona e kufizuar me vijëzime të fuqishme tregon kompetencat e vendimmarrjes politike dhe veprimit – janë kufizuar më fuqishëm për shkak të lidhjeve të tyre të ngushta me pjesëmarrjen në demokraci. Rreshtat më poshtë tregojnë lidhjet me kapitujt e tjera në këtë manual: çfarë kompetencash zhvillohen në këto kapituj që mbështesin nxënësit në njësinë 3?

Si mund të përdoret kjo matricë

Mësuesit mund ta përdorin këtë matricë si mjet për planifikimin orëve të EQD / EDNJ në mënyra të ndryshme.

- Matrica e bën mësuesit të vetëdijshëm për pasojat e sinergjisë që ndihmojnë nxënësit të trajnohen në mënyrë të përsëritur në kompetenca më të rëndësishme, në kontekste të ndryshme që janë të lidhura në shumë mënyra.

- Kjo matricë ndihmon mësuesit të cilët kanë vetëm disa orë në dispozicion të EQD / EDNJ: një mësues mund të zgjedhë vetëm këtë kapitull dhe të heqë të tjerat, pasi ai e di që disa kompetenca kyçe janë zhvilluar, në një masë të caktuar, në këtë kapitull - për shembull, të bërit e një zgjedhje, të kuptuarit e pluralizmit të identiteteve, ushtrimi i të drejtave të lirisë, përgjegjësinë në bërjen e zgjedhjeve që ndikon te të tjerët.

Kapitujt	Dimensionet e zhvillimit të kompetencave			Qëndrimet dhe vlerat
	Analiza dhe gjykimi politik	Metodat dhe aftësitë	Vendimmarrja dhe veprimi politik	
3. Diversiteti dhe pluralizmi	Identifikimi i fushave të qëllimeve të përbashkëta dhe konflikti Dy dimensionet e politikës: zgjidhja e problemeve dhe lufta për pushtet	E folura në publik Apelimi ndaj të tjerëve Menaxhimi kohës	Identifikimi i përparësive politike dhe qëllimeve Negocimi dhe vendimmarrja	Vetëbesimi, vetëvlerësimi Gatishmëria për kompromis
6. Qeverisja dhe politika	Politika: një proces i zgjidhjes së problemeve Dimensioni i pushtetit në hartimin e agjendës			
4. Konflikti			Negocimi dhe vendimmarrja	
5. Rregullat dhe ligjet			Rënia dakord për një kuadër të rregullave	Njohja reciproke

KAPITULLI 3: Diversiteti dhe pluralizmi - Pëlqimi përmes mospajtimit?

Si mund të biem dakord për të mirën e përbashkët?

Tema e mësimit	Trajnimi i kompetencës/objektivat e të mësuarit	Detyrat e nxënësve	Materialet dhe burimet	Metoda
Mësimi 1 Nëse unë do të isha president ...	Përcaktimi i përparësive politike, duke vepruar brenda parametrave të diskutimit publik dhe vendim-marrjes, duke jetuar me situata të hapura të "konfuzionit". të bërit e një zgjedhje dhe reflektimi për kriteret. Krijimi i një matrice bazuar në kategoritë. Hartimi i një deklaratë të shkurtër dhe ofrimi i arsyeve. Katër qëndrimet bazë politike: liberale, social demokrate, konservatore e gjelbër.	Nxënësit përcaktojnë, paraqesin dhe krahasojnë përparësitë e tyre politike.	Fletë A3 (një e dhënë për nxënësit). Materialet për mësuesit 3A. Fleta e punës e nxënësit 3.1. Një rrip letre për çdo nxënës, mundësisht një lapustil secilit.	Prezantimi dhe analiza e deklaratave politike; punë individuale; diskutime plenare.
Mësimi 2 Çfarë qëllimesh duam të promovojmë?	Negocimi, balancimi këmbëngulja në qëllimet e dikujt, dhe njohja e qëllimeve të tjerëve. Partitë politike gjenerojnë fuqinë e nevojshme për të promovuar qëllimet politike. Ata e bëjnë këtë duke bashkuar dhe bërë kompromise.	Nxënësit negociojnë një agjendë të përbashkët të përparësive politike. Ata paraqesin profilet e tyre partiake në një event publicitar.	Fletët e punës së nxënësve 3,1-3,4. Materialet për mësuesit 3B.	Puna në grup, prezanti me plenare, leksion.
Mësimi 3 Çfarë është e mira e	Pjesëmarrja: aftësitë negociuese. Analiza e qëllimeve për qëllimin e përbashkët.	Nxënësit negociojnë një vendim.	Shirita letre A4 dhe lapustil. Shirita demonstrimi për	Shirita letre A4 dhe lapustil. Shirita demonstrimi për

përbashkët?	Politika ka dy dimensione: zgjidhjen e problemeve dhe luftën për pushtet. Kompromisi është çmimi që paguhet për mbështetjen dhe për një marrëveshje.		"analizën diamant".	"analizën diamant".
Mësimi 4 Pjesëmarrja në demokracinë pluraliste	Strukturimi i rezultateve të punës së dikujt. Hartimi i deklaratave të shkurtra, duke ofruar vlerësime. Pluralizmi mbështet vendimmarrjen e drejtë dhe efektive. "Aprovimi përmes mospajtimit." Unë promovoj interesat e mia, duke marrë pjesë në demokraci.	Nxënësit reflektojnë dhe diskutojnë për përvojën e tyre dhe japin reagime rreth kapitullit.	Tabelë dhe lapustila, një kopje e fletëtëve të punës së nxënësve 2.5 (UDHR) dhe 2.6 (ECHR). "Muri i heshtjes".	Punë individuale, prezantim dhe diskutim. Një seancë me ndriçues.

Mësimi 1

Po të isha president...

Nxënësit përcaktojnë përparësitë e tyre politike

<p>Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimin.</p> <p>Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD / EDNJ.</p> <p>Objektivi i mësimin tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.</p> <p>Detyra e nxënësit, së bashku me metodën, formojnë bërthamën e procesit mësimor.</p> <p>Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimin.</p> <p>Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.</p>	
Trajnimi i kompetencës	Pjesëmarrja: përcaktimi i përparësive politike, veprimi brenda parametrave të diskutimit publik dhe vendim-marrja, duke jetuar me situatat e hapura të "konfuzionit". Gjykimi: të bërit e një zgjedhje, dhe reflektimi për kriteret. Analiza: krijimi i një matricë bazuar në kategoritë. Metodat dhe aftësitë: hartimi i një deklaratave të shkurtër dhe ofrimi i arsytimit.
Objektivat e të mësuarit	Nxënësit janë në gjendje të përcaktojnë pozicionin e tyre në mes të katër qëndrimeve themelore politike: liberale, social demokrate, konservatore dhe e gjelbër.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit përcaktojnë, paraqesin dhe krahasojnë përparësitë e tyre politike.
Materialet dhe burimet	Fletë A3 (një e dhënë për nxënësit). Materialet për mësuesit 3.A Fletët e punës së nxënësit 3.1 Një rrip letre për çdo nxënës, mundësisht një lapustil secilit.
Metoda	Paraqitja dhe analiza e deklaratave politike; punë individuale; diskutime plenare.
Koha në dispozicion	Faza 1: Nxënësit përcaktojnë qëllimet politike. 25 min
	Faza 2: Nxënësit analizojnë vendimet e tyre. 15 min

Informacion

Në mësimin e parë, nxënësit përjetojnë klasën e tyre si një mikro shoqëri. Ata krijojnë një shumëllojshmëri të pikëpamjeve individuale dhe të preferencave politike. Nxënësit do kuptojnë se një situatë e tillë duhet të sqarohet. Nëse secili prej tyre imagjinojnë se është lider politik i vendit të vet dhe përcakton përparësitë e tij më të larta, është e qartë se duhet të bëhen disa zgjedhje.

Mësuesi lehtëson procesin që vijon në këtë mësim dhe në atë pasardhës. Nëse nxënësit i marrin seriozisht qëllimet e tyre, ata do të jenë të interesuar në bisedime e marrëveshje për një vendim që ata mund të pranojnë.

Përshkrimi i mësimit

Faza 1: Nxënësit përcaktojnë qëllimet politike

Hapi 1.1: Përgatitja

Nxënësit dhe mësuesi janë të ulur në një rreth me një hapësirë të hapur në katin e në mes. Tavolinat janë lëvizur mënjanë; të paktën një tavolinë në çdo cep të klasës është gati për përdorim.

Nxënësit kanë pajisjet e tyre në dorë për të marrë shënime.

Çdo nxënës merr një rrip letre, mundësisht një lapustil secili.

Mësuesi ka fletën A3 në dorë ("Nëse do të isha president ..."), shih më poshtë.

Hapi 1.2: Nxënësit bëjnë vendimet e tyre⁸

Mësuesi u shpjegon nxënësve se ky është fillimi i një njësie të re. Nxënësit njihen me temën përmes një aktiviteti me udhëzimin e mëposhtëm:

Imagjinoni se sa jeni bërë presidenti⁹ i këtij vendi.

*Nëse do të isha president i vendit tonë,
përparësia im i lartë do të jetë ...*

Mësuesi vendos fletën me të dhënat në mes të rrethit.

Cili do të jetë përparësia juaj më e lartë?

Plotësoni këtë deklaratë. Këtu janë disa pika që mund të merren në konsideratë:

Ju mund të zgjidhni të prezantoni një masë konkrete për të arritur një qëllim menjëherë - ose të ndërmerreni një hap të parë në rrugën për arritjen e një qëllimi afatgjatë.

Cili grup, çështje apo problem ju shqetëson më shumë?

Nxënësit duhet të mendohen për këto pyetje në heshtje dhe shkruajnë vendimet e tyre në shiritin e tyre të letrës. Ata nuk duhet t'i ndajnë ende idetë e tyre, pasi kjo do të ndodhë në raundin plenar.

Çdo nxënës duhet të paraqesë vetëm një vendim. Nëse ata kanë më shumë alternativa në mendje, duhet t'i regjistrojnë këto në shënimet e tyre.

Hapi 1.3: Nxënësit paraqesin vendimet e tyre

Nxënësit paraqesin vendimet e tyre me radhë. Ata plotësojnë deklaratën "Përparësia im më e lartë do të jetë ..." dhe japin arsyet e tyre kryesore. Ata e vënë poshtë rripin e tyre në hapësirën e hapur në dysheme.

Mund të pritët se disa nxënës do të arrijnë në ide të ngjashme. Sa më shpejt të ndodhë kjo, mësuesi e tregon këtë dhe sugjeron grupimin e këtyre deklaratave së bashku. Shirita janë po ashtu të grumbulluara dhe një titull i përshtatshëm i jepet si psh "Lufta kundër varfërisë", ose "Përmirësimi i edukimit".

Mësuesi i nxit nxënësit që të bashkohen në strukturimin e të dhënave. Nuk ka diskutim të mëtejshme apo komente për vetë vendimet këto vazhdojnë për aq kohë sa të gjithë nxënësit të kenë pasur mundësi nga ana e tyre për të marrë fjalën.

Rezultati do të jetë ndoshta me disa grupe, dhe ndoshta edhe disa deklaratat që qëndrojnë të vetme.

⁸ This method is a variation of Exercise 6.3, "If I were a magician" in *Teaching democracy*, EDC/HRE Volume VI, Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2008, p. 59.

⁹ The teacher uses the official term for the head of government in the country.

Faza 2: Nxënësit analizojnë vendimet e tyre

Hapi 2.1: Nxënësit përshkruajnë shumëllojshmërinë e zgjedhjeve të tyre

Mësuesi lehtëson këtë hap me një pyetje të hapur:

- Përshkruani "peizazhin politik" që ju vetë keni krijuar.

Disa nxënës duhet të përgjigjen. Ata mundet shumë mirë të adresojë pyetjet e mëposhtme; nëse jo, mësuesi e bën këtë:

- Cila është ideja themelore që lidh idetë që formojnë grupime dhe, për çfarë arsyeje, nxënësit e tjerë kanë zgjedhur një pozicion tjetër?

Nxënësit do të përshkruajnë strukturën e diversitetit. Ndërkohë që ata janë duke u marrë me alternativa për një vendim politik, dhe jo me një shkëmbim të hapur të ideve, ata do të bëhen të vetëdijshëm për nevojën e arritjes së një marrëveshje - duke sjellë disa sugjerime së bashku, dhe duke përjashtuar të tjerat. Pasuria e ideve është produkt i shumë qytetarëve që marrin pjesë në diskutim, duke ushtruar lirinë e tyre të mendimit, të opinionit dhe të shprehjes. Një vendim duhet të merret, por kush e merr atë?

Nëse është e nevojshme, mësuesi udhëzon nxënësit për këtë thellim vendimtar.

Hapi 2.2: Mësuesi jep një kontribut të informimit për qëndrimet themelore politike

Çdo cep i dhomës qëndron për një nga katër pikëpamjet politike. Mësuesi ka dhënë letrat informuese (të përgatitura me copa të prera nga materialet për mësuesit 3A) për tavolina. Mësuesi paraqet çdo pozicion me radhë dhe një nxënës lexon deklaratat për klasën.

Mësuesi fton nxënësit që të përdorin këtë informacion:

- Cili këndvështrim bazë korrespondon me deklaratën e tyre politike, apo grupimin, dhe cili jo?
- A munden ata të identifikohen me ndonjë pozicion, apo janë diku në mes? Ose a do të preferojnë ata të përcaktohen në një pozicion të ri?

Mësuesi shpërndan Fletën e punës së nxënësit 3.1 – programin e njësisë. Sfida për nxënësit është përcaktimi i pozicionit të tyre në "peizazhin politik". Partitë politike janë ndërmjetës të rëndësishëm midis interesave të ndryshme, vlerave dhe preferencave. Nxënësit janë të ftuar të formojnë parti me qëllim promovimin e qëllimeve politike që kanë paraqitur në këtë mësim. Mësuesi shton se nxënësit po ushtrojnë të drejtën njerëzore të pjesëmarrjes në politikë. Ata janë të lirë t'i bashkohen ose ta lënë një parti, për të krijuar një parti të re ose të qëndrojnë jashtë partive. Modelet planifikojnë një proces vendimmarrjeje politike - nga qëllimet politike në mendjet e njerëzve, në marrëveshjet e përkohshme për të mirën e përbashkët.

Hapi 2.3: Nxënësit takohen në partitë e tyre të reja

Gjatë minutave të fundit të mësimin, nxënësit takohen në partitë e tyre. Ata marrin dhe Fletën e punës së nxënësit t 3.2 dhe 3.3, për të mbështetur ata në diskutimet e tyre. Mësuesi flet me nxënësit të cilët kanë zgjedhur të mos bashkohen apo të formojnë një parti. Ata duhet të kuptojnë se në këtë vend, si në realitet, partitë janë lojtarët më të fortë dhe do të marrin udhëheqjen. Nëse ata e marrin qëllimet e tyre seriozisht, ata duhet të kenë një interes që t'i shohin ato të vëna në praktikë. Që të ndodhë kjo, është e nevojshme një element i pushtetit. Palët kanë mundësi të krijojnë një potencial të tillë për pushtet. Prandaj nxënësit duhet të marrin parasysh një nga opsionet e mëposhtme:

- Nëse ju keni alternativa të tjera, ndoshta të vërejtura më parë, shqyrtoni mundësinë t'i bashkoheni një partie në bazë të qëllimeve të tilla.
- Bisedoni me njëri-tjetrin për të mësuar nëse mund të krijoni një parti.
- Prisni për deklaratat politike të partive dhe pastaj bëni një zgjedhje.

Mësimi 2

Çfarë qëllimesh duam të promovojmë? Nxënësit formojnë partitë politike

Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.

Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD/EDNJ.

Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.

Detyra e nxënësit, së bashku me **metodën**, formojnë bërthamën e procesit mësuesor.

Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.

Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.

Trajnimi i kompetencës	Pjesëmarrja: Negocimi – këmbëngulja e balancimit për qëllimet vetjake dhe njohja e qëllimeve të tjerëve.
Objektivat e të mësuarit	Partitë politike gjenerojnë pushtetin e nevojshëm për të promovuar qëllimet politike. Ata e bëjnë këtë duke bashkuar pikëpamjet dhe interesat e anëtarëve individualë, që nevojiten për kompromise.
Detyrat e nxënësve	Nxënësit negociojnë një agjendë të përbashkët të përparësive politike. Ata paraqesin profilet e tyre partiake në një event publiciteti.
Materialet dhe burimet	Fletët e punës së nxënësit 3.1-3.4. Materialet për mësuesit 3B.
Metoda	Punë në grupe, prezantime plenare, leksion.
Koha në dispozicion	Faza 1: Nxënësit përcaktojnë profilet e partive të tyre. 15 min
	Faza 2: Event publiciteti: palët paraqesin profilet e tyre. 10 min
	Faza 3: Mësuesi prezanton konceptin konstruktivist të të mirës së përbashkët. 5 min
	Faza 4: Nxënësit diskutojnë strategjitë e tyre të negociatave. 10 min

Informacion

Nxënësve u është dhënë shumica e mësimit për aktivitetet e tyre dhe duhet t'i përfundojnë ato brenda në një afati të ngjeshur kohor (Fletët e punës së nxënësit 3.1).

Mësuesi jep një leksion të shkurtër që i mundëson nxënësve një këndvështrim të ri në përvojën e tyre aktuale. Mësuesi trajton shumë probleme që nxënësit tashmë i dinë dhe paraqet konceptet kyçe të këtij kapitulli - diversitetin, pluralizmit, të mirën e përbashkët.

Përmes këtij bashkëveprimi të të mësuarit konstruktivist, udhëzimit dhe një faze të re të mësuarit konstruktivist, konceptet bëhen të rëndësishme për nxënësit, sepse ato i ndihmojnë ata të kuptojnë situatën në të cilën janë.

Përshkrimi i mësimit

Mësuesi i referohet rendit të ditës të mësimit (dhe prospektet nxënës 3.1). Partitë miratojnë pozicionin e tyre në "peizazhin politik" - fjalë për fjalë duke marrë vendet e tyre atje - dhe të punojnë jashtë profileve të tyre. Eventi i publicitetit do t'i ndihmojë të gjithë për të përcaktuar pozicionin e tyre - në bashkëpunim apo në konfrontim me partitë e tjera.

Faza 1: Nxënësit përcaktojnë profilet dhe agjendat e partive të tyre

Hapi 1.1: Nxënësit identifikojnë pozicionin e tyre në "peizazhin politik"

Nxënësit që kanë grupuar deklaratat e tyre politike në mësimin e mëparshëm, duhet të vendosin se ku do të pozicionohen në "peizazhin politik". Ata shënojnë pozicionin me bankat dhe karriget e tyre. Pozicioni i tyre mund të jetë në një qoshe ose kudo në mes. Në këtë mënyrë, hapësira ndërmjet palëve tregon, në një kuptim shumë të saktë, se cilat palë janë më afër apo në kundërshtim me njëri-tjetrin. Sa më afër që të jenë dy parti, aq më të mira janë shanset e tyre për të formuar një koalicion me qëllime të përbashkëta.

Nxënësit të cilët kanë zgjedhur të mos bashkohen me ndonjë parti, mbledhen në një zonë të lirë, mundësisht në mes të dhomës. Ata ndajnë pikëpamjet e tyre. Nëse ata dëshirojnë, mësuesi bashkohet me ta si ndërmjetës. Ai nuk duhet t'i bindë ata që të bashkohen në ndonjë parti, por dëgjon pyetjet dhe kundërshtimet e tyre. Nxënësit vendosin nëse dhe si të marrin pjesë, jo mësuesi.

Palët duhet të pranojnë anëtarë të rinj në çdo kohë, si në realitet. Nxënësit kanë gjithashtu të drejtë të largohen nga një parti.

Hapi 2.2: Partitë përcaktojnë profilet e tyre

Të udhëhequr nga Fletët e punës së nxënësit 3.2 dhe 3.3, nxënësit punojnë jashtë profileve të partive të tyre. Mësuesi shikon dhe dëgjon, dhe ndërhyt vetëm nëse kërkohet mbështetja e tij ose në rast të problemeve serioze.

Faza 2: Publiciteti - palët paraqesin profilet e tyre

Kjo është një publicitet për partitë, jo për nxënës të veçantë. Kjo mund të justifikohet me sasinë e kufizuar të kohës në dispozicion. Partitë mbledhin pikëpamjet e individëve, që shërben për të zvogëluar diversitetin e mendimeve individuale.

Secila parti ka të njëjtën sasi të kohës - 2 ose 3 minuta, në varësi të numrit të përgjithshëm të partive. Mësuesi e bën të qartë këtë për nxënësit, ndërsa ata janë duke përgatitur prezantimin e tyre, dhe zbaton këtë rregull në mënyrë rigorozë - për arsye të dukshme të drejtësisë.

Siç sugjerohet në Fletën e punës së nxënësit 3.2, folësit mund të pritët që të apelojë ndaj nxënësve të cilët nuk e kanë bërë ende zgjedhjen e tyre. Së dyti, ata mund të bëjnë përpjekje për të konkurruar me partitë e tjera. Fletushkat apo posterët mund të mbështesin palët.

Të gjithë nxënësit, qofshin anëtarë partie apo jo, mund të vendosin të bashkohen ose të lënë një parti pas publicitetit.

Faza 3: Mësuesi jep kontribut për reflektim: e mira e përbashkët

Kjo e dhënë - një leksion i shkurtër i mbështetur edhe nga Fleta e punës së nxënësit 3.4 - shërben për të lidhur eksperiencën e nxënësve me konceptet kyçe të diversitetit dhe pluralizmit. Duke futur leksionin në kontekstin e përvojës dhe bashkëveprimit që nxënësit kanë krijuar, ne kemi krijuar bashkëveprimin ndërmjet të mësuarit konstruktivist dhe msimdhënies sistematike.

Materialet për mësuesit 3B japin një projekt-skicë për leksionin.

Nxënësit mund të kërkojë sqarime të mëtejshme nëse është e nevojshme. Përndryshe nuk ka nevojë për diskutim, meqenëse nxënësit mund të mendojnë për këtë problem në veprimtarinë e tyre të mëtejshme.

Faza 4: Partitë përgatisin strategjitë e tyre të negociatave

Mësuesi i referohet planit (dhe Fletës së punës së nxënësit 3.1). Në mësimin e ardhshëm, palët kanë mundësi për të negociuar me njëri-tjetrin. A do munden ato të formojnë një aleancë, një koalicion? Do të zhvillohet një tryezë e rrumbullakët për t'i dhënë të gjitha palëve dhe nxënësve të veçantë mundësinë për të negociuar idetë e tyre për të mirën e përbashkët. Në fazën e fundit të këtij mësimi, nxënësit mund të përgatisin strategjitë e tyre për negociatat.

- Cilat qëllime do të kenë përparësi?
- Cilat parti ose palë do të duan të përballen në raundin e parë të bisedimeve dypalëshe?
- Sa delegacionet do ngrëjë partia?

Nxënësit rifillojnë diskutimet e tyre të brendshme në partitë e tyre. Ata punojnë më vete, përveç rasteve kur është e nevojshme mbështetja e mësuesit.

Mësimi 3

Çfarë është e mira e përbashkët?

Pëlqimi përmes mospajtit

Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimit.

Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD / EDNJ.

Objektivi i mësimit tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.

Detyra e nxënësit, së bashku me **metodën**, formojnë bërthamën e procesit mësuesor.

Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimit.

Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.

Trajnimi i kompetencës	Pjesëmarrja: aftësitë negociuese. Analiza: analizimin i qëllimeve për qëllime të përbashkëta.	
Objektivat e të mësuarit	Politika ka dy dimensione: zgjidhjen e problemeve dhe luftën për pushtet. Kompromisi është çmimi që paguajmë për mbështetjen dhe një marrëveshje.	
Detyrat e nxënësve	Nxënësit negociojnë një vendim.	
Materialet dhe burimet	Shirita letër A4 dhe lapustila. Shirita demonstrimi për "analizën diamanti".	
Metoda	Loja e vendimmarrjes; individuale, në grup dhe seancë plenare.	
Koha në dispozicion	Faza 1: Nxënësit përcaktojnë propozimet e tyre.	10 min
	Faza 2: Nxënësit negociojnë në një tryezë të rrumbullakët.	30 min

Informacion

Njësia modelon procesin e negocimit të qëllimeve të përcaktuara nga një kuptim i përbashkët i së mirës së përbashkët. Në këtë mësim, detyra e nxënësve është që të përpiqen për këtë qëllim. Ata mund të kenë sukses, ose ata edhe mund të mos kenë. Përpjekjet dhe përvoja e tyre është po aq e rëndësishme sa edhe rezultati.

Mësuesi vazhdon kryerjen e rolit të një lehtësuesi. Për shembull, ai paraqet modele për negociata, por nuk komenton përmbajtjen.

Gjatë fazës së parë, vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet atyre nxënësve që përjetojnë përjashtimin për shkak se nuk i ishin bashkuar një partie.

Përshkrimi i mësimit

Fillimi: mësuesi jep detaje të planit

Mësuesi i referohet planit (Fletët e punës së nxënësit 3.1) dhe i kujton nxënësit për detyrën e tyre. Në këtë mësim, ata do të negociojnë një agjendë politike. Çfarë qëllimesh propozojnë ata?

Faza 1: Nxënësit përcaktojnë qëllimet e tyre

Nxënësit vendosin për qëllimet që do propozohen. Si partitë edhe individët mund të bëjnë propozime. Kjo duket se u jep nxënësve individualë, të "pa-angazhuar", një avantazh; por nga ana tjetër, propozimi i një partie ka shans më të mirë për të qenë më i votuar në fund të ditës.

Folësit e grupit ose nxënësit individualë përgatitin një deklaratë të shkurtër promovimi. Nxënësit e shënojnë qëllimin e tyre në një shirit letre duke përdorur një lapustil.

Faza 2: Nxënësit negociojnë në një "tryezë të rrumbullakët"

Mësuesi këmbëngul në fillimin në kohë. Nxënësit janë ulur në një rreth me karrige; kjo nuk i përshtatet mjaft metaforës së fjalës "tryezë e rrumbullakët", por e mbështet më mirë komunikimin. Partitë që kanë formuar një koalicion ulen pranë njëra-tjetrës.

Hapi 2.1: Nxënësit bëjnë propozimet e tyre

Mësuesi hap bisedimet e tryezës së rrumbullakët dhe i jep çdo kryetari partie dhe nxënësve individualë, mundësinë për të marrë fjalën. Mësuesi u kërkon atyre të raportojnë për çdo marrëveshje që kanë bërë dhe të bëjnë një propozim për një vendim të përbashkët. Ata vënë në dispozicion rripin e tyre të letrës në dysHEME.

Hapi 2.2: Nxënësit analizojnë qëllimet e tyre dhe shqyrtojnë mundësitë e kompromisit dhe integritit


Pasi të gjithë kanë folur, mësuesi lehtëson lidhjet e mundshme dhe kompromiset mes propozimeve të nxënësve.

- A përshtaten propozimet mirë me njëri tjetrin? A mund të grupohen kartat?
- Cilat propozime përjashtojnë njëra-tjetrën? Këtu nxënësit duhet të shikojnë propozimet me kujdes. A e përjashtojnë qëllimet njëri-tjetrin? Apo qëllimet ndajnë të njëjtin synim, por kërkojnë përpjekje të mëdha, së bashku me burime ose të holla?

Hapi 2.3: Mësuesi sugjeron një model për negociatën

Mësuesi sugjeron një model për të hartuar një agjendë politike të qëllimeve për të mirën e përbashkët. Me shirita letre A4 të shënuara me numra, siç tregohet më poshtë, ai prezanton modelin nr 1, një version i thjeshtuar i modelit klasik të "analizës diamant" (Modeli Nr 3).

Në variantin me katër qëllime, një qëllimi i është dhënë prioritet më i lartë. Dy qëllimet të tjera kanë marrë radhën e dytë dhe një qëllimi që është konsideruar më pak i rëndësishëm ose urgjent është futur në radhën e 3 (ose është lënë tërësisht jashtë - atëherë mësuesi heq qëllimin nr 3).



Ky model i përmbledhur, me tre ose katër qëllime, kërkon negocime, meqenëse shumë qëllime nuk mund të lejohen. Nga ana tjetër, më pak qëllime vihen më lehtë në jetë sesa një agjendë me të cilën gjithkush do të ishte i kënaqur, por më e komplikuar për t'u trajtuar (dilema mes përfshirjes dhe efikasitetit). Mësuesi shton shiritat për ta kthyer modelin nr 1 në modelet Nr. 2 dhe 3.

Në fund, mësuesi thekson se të gjitha modelet përcaktojnë vetëm një prioritet të lartë. Pra, më tej një alternativë radikale do të ishte përcaktimi i vetëm një qëllimi:

1

Hapi 2.4: Nxënësit negociojnë

Nxënësit kanë disa pyetje për të cilat duhet të bien dakord. Në të njëjtën kohë, këto pyetje hapin rrugë të ndryshme për kompromise dhe mbështetje të shumicës.

- Cilin model do të zgjedhim - sa qëllime do të përfshijmë?
- Cilave qëllimeve do t'i japim përparësi të lartë?
- A mundemi ne të gjithë të biem dakord me një qëllim të vetëm?
- Cilat qëllimet do të përfshijmë në agjendën tonë? Qëllimet që mbështesin njëri-tjetrin, apo ato që përjashtojnë njëra-tjetrën? (Alternativa e parë punon për efikasitetin, e dyta për përfshirjen.)
- A ka kuptim agjenda në tërësi?

Këtu nevojitet arsyetim dhe argumentim i kujdesshëm. Partitë kanë mbështetje më të fortë për qëllimet e tyre, por të tjerët mund të kenë ide më të mira. Prandaj mbetet një çështje e hapur se cilat janë qëllimet që do fitojnë mbështetjen më të lartë.

Përfshirja e qëllimeve që përjashtojnë njëra-tjetrën (p.sh. të gjelbërit + konservatorët) është tipike për koalicionet mes partive ose qeverisjeve gjithë-partiake. Modeli i efektshëm i qëllimeve (të gjitha të përcaktuara nga një parti) është më konkurrues dhe i orientuar drejt konfliktit. Zgjedhja mes këtyre modeleve është edhe një zgjedhje e kulturave politike - mënyrat për të trajtuar pluralizmin në demokraci. Mësuesi vëren se si nxënësit trajtojnë këtë çështje dhe vendos nëse do ta trajtojnë atë në mësim e reflektimit.

Nxënësit ndryshojnë kartat në dysheme për të krijuar modelin e tyre të agjendës (për të formuar një formë diamanti ose piramidale). Nëse disa modele përfshijnë të njëjtat qëllime, përdoren kopjet identike që të mund të krahasohen.

Kartat më në fund mbërthehen në tabelë për të krijuar postera. Këto do të përdoren në mësimin në vijim.

Hapi 2.5: Nxënësit votojnë

Në fund të takimit, nxënësit votojnë. Në qoftë se ata kanë rënë dakord për një grup qëllimesh, mund të pritet një votim unanim.

Nëse kanë dalë modele të ndryshme, nxënësit votojnë për këto modele.

Në këtë rast mësuesi sugjeron procedurën e mëposhtme të votimit, e cila duhet të vendoset (me votim) para se të fillojë votimi i modeleve: nëse ndonjë nga modelet fiton një shumicë prej për 50%, ai pranohet. Përndryshe zhvillohet një votim i dytë, këtë herë midis dy modeleve me numrin më të madh të votave. Për të llogaritur edhe abstenimet, pranohet modeli me numrin më të lartë të votave.

Mësimi 4

Pjesëmarrja në demokracinë pluraliste

Nxënësit reflektojnë për përvojën e tyre

<p>Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimi.</p> <p>Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD / EDNJ.</p> <p>Objektivi i mësimi tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.</p> <p>Detyra e nxënësit, së bashku me metodën, formojnë bërthamën e procesit mësimor.</p> <p>Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimi.</p> <p>Koha në dispozicion na jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.</p>	
Trajnimi i kompetencës	<p>Analiza dhe gjykimi: strukturimin i rezultateve të punës së dikujt.</p> <p>Aftësitë metodike: hartimi i deklaratave të shkurtra, duke dhënë reagime.</p>
Objektivat e të mësuarit	<p>Pluralizmi mbështet vendimmarrjen e drejtë dhe efektive. "Aprovimi nëpërmjet mospajtitimit."</p> <p>Unë promovoj interesat e mia duke marrë pjesë në demokraci.</p>
Detyrat e nxënësve	<p>Nxënësit reflektojnë dhe diskutojnë për përvojën e tyre dhe japin reagime për njësinë mësimore.</p>
Materialet dhe burimet	<p>Tabelë dhe lapustila; një kopje e fletëve të punës së nxënësve 2.5 (UDHR) dhe 2.6 (KEDNJ).</p>
Metoda	<p>Muri i heshtjes". Punë individuale, prezantim dhe diskutim. Rrethi me elektrik dore.</p>
Koha në dispozicion	<p>Faza 1: Nxënësit reflektojnë për përvojën e tyre ("Muri i heshtjes"). 20 min</p>
	<p>Faza 2: Diskutimet që pasojnë. 15 min</p>
	<p>Faza 3: Nxënësit japin reagimet. 5 min</p>

Informacion

Reflektimi është të mësuar konstruktivist. Nxënësit formojnë pikëpamjet e tyre dhe i ndajnë ato me njëri-tjetrin. Roli i mësuesit është të sigurojë një kuadër të metodave të përshtatshme dhe planifikimit. Ky është një shembull i mësimdhënies përmes të drejtave të njeriut: nxënësit të ushtrojnë lirinë e mendimit dhe të shprehjes. Kuadri i rreptë i jep çdo nxënësi një mundësi për të marrë pjesë. Këto mundësi nuk do të perceptohen kurrë si të barabarta, sepse lloje të ndryshme të mësimi i përgjigjen ndryshe metodave që mësuesi ka zgjedhur.

Mësuesi merr vetëm një sasi të vogël të kohës për të folur. Megjithatë, përmes përcaktimit të kornizës dhe orarit të mësimi, lidhshipi i mësuesit është i pranishëm gjatë gjithë kohës. Si në kapitujt e tjera, nxënësit përjetojnë paradoksin se liria jo vetëm shkon mirë së bashku me rregullat dhe udhëheqjen e ngurtë, por edhe mund t'i kërkojë ato.

Përshkrimi i mësimit

Përgatitjet:

Modelet e agjendës politike që nxënësit kanë votuar në mësimin e mëparshëm janë varur në mur. Katër tabela ("Muret e heshtjes") janë të varura rreth e qark klasës, me 2-3 lapustila me ngjyra të ndryshme vendosur aty pranë. Tabelat duhet të jenë të mundshme për t'u arritur, me 5-6 karrige në formë gjysmërrethi pranë tyre. Një alternative tjetër mund të jetë që tabela të jetë e shtrirë sipër dy ose tri tavolinave të vendosura së bashku.

Mësuesi i ka përgatitur tabelat para mësimit duke shkruar edhe pyetjet kryesore (shih më poshtë). Tabela rezervë janë pranë në qoftë se nxënësit kanë nevojë për hapësirë shtesë për të shkruar.

Vendosja e karrigeve ndihmon komunikimin. Për këtë arsye, karriget vendosen në formë rrethi, në një shesh të hapur - çdo gjë duhet të përshtatet me vendosjen e tabelave.

Faza 1: Nxënësit reflektojnë për përvojën e tyre ("Muret e heshtjes")

Hapi 1.1: Mësuesi udhëzon nxënësit se si të përdorin "muret e heshtjes"¹⁰

Nxënësit dhe mësuesi janë ulur. Mësuesi i referohet temës së mësimit në orar (Fletët e punës së nxënësit 3.1) - duke reflektuar për çfarë bërë, në vend që të japë të dhëna të reja ose një detyrë të re. Në një seancë reflektimi, nxënësit duhet të mendojnë, të ndajnë idetë e tyre dhe t'i diskutojnë ato.

Mësuesi paraqet metodën "muri i heshtjes" dhe shpjegon se pse e ka zgjedhur atë: ajo është një metodë e mirë për të mbështetur reflektimin dhe kjo u jep nxënësve kohë të mjaftueshme për të menduar dhe komunikuar.

Mësuesi i referohet katër posterëve - katër "mure të heshtjes":

- **Pluralizmi**
Si e kam përjetuar pluralizmin?
- **Pëlqimi përmes mospajtit?**
Për çfarë arsyesh ishim të suksesshëm ose dështuam, duke rënë dakord për një përkufizim të së mirës së përbashkët?
- **Shpërndarja e ndryshme e pushtetit**
Si u ndjemë ne duke qenë pjesë e më të fortëve apo e më të dobëtëve?
- **Të drejtat e njeriut**
Cilat të drejta të njeriut kemi ushtruar në këto mësim? (Kopje të Fletët e punës së nxënësit 2.5, Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, dhe 2.6, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ofrohen në këtë pikë.)

Udhëzime:

- Duhet të ketë heshtje gjatë gjithë ushtrimit - kështu e ka emrin edhe ushtrimi "muri i heshtjes". Ai është një diskutim në formë të shkruar.
- Çdo nxënës mund të shkruajë sa të dëshirojë.
- Kërkesa minimale: dy shënime, secili në dy "mure të heshtjes".
- Nxënësit mund të shkruajnë përgjigjen e tyre për pyetjen kyçe ose të komentojnë për atë që ka shkruar një nxënës tjetër. Për këtë, mund të përdoren shigjeta, vija dhe simbole
- Nxënësit mund të ecin për qark ose të qëndrojnë në një poster.

¹⁰ This method is a variation of Exercise 7.1, "The wall of silence", in *Teaching democracy*, EDC/HRE Volume VI, Council of Europe Publishing, Strasbourg, 2008, p. 62.

Hapi 1.2: Nxënësit shkruajnë idetë e tyre në "muret e heshtjes".

Nxënësit kryejnë ushtrimin e reflektimit sipas udhëzimeve. Mësuesi ndjek shkëmbimin e ideve dhe mendimeve, por nuk merr pjesë. Mësuesi këmbëngul që sundimi i heshtjes të respektohet në mënyrë rigorozë nga të gjithë.

Kjo fazë zgjat 10-15 minuta.

Faza 2: Diskutimi në vijim

Mësuesi kërkon që nxënësit të zënë vendet e tyre (rreth me karrige ose në një shesh të hapur) dhe shpall fazën tjetër: diskutim që drejtohet nga mësuesi.

Së pari nxënësit duhet të bien dakord për temat që duan të diskutojnë. Mësuesi i bën ata të vetëdijshëm për nevojën për të bërë një zgjedhje në kohën në dispozicion. Kjo sugjeron fokusimin në një ose dy "mure të heshtjes" në vend të komentimit shkurtimisht për secilin. Megjithatë, kjo është çështje që vendoset nga nxënësit.

Një diskutim i tillë është pjesë e të mësuarit konstruktivist. Mësuesi nuk mundet dhe nuk nevojitet, të parashikojë çfarë do të thonë nxënësit. Detyra e mësuesit është të japë strukturën për kontributet e nxënësve.¹¹

Faza 3: Reagimet (rreth e rrotull me "ndriçimin")

Mësuesi shpall fundin e diskutimit me qëllim që të mund të mbahet një raund përfundimtar reagimesh për njësi. Metoda përbëhet nga një raund deklaratash "ndriçuese". Çdo nxënës plotëson deklaratën e mëposhtme:

"Gjëja më interesante apo e rëndësishme që kam mësuar në këtë kapitull është ..."

Nga ana tjetër, çdo student bën një deklaratë të shkurtër prej 1-2 fjali. Komentet nuk lejohen. Nxënësit janë të lirë të përsëritin dhe të theksojnë deklaratat e njëri-tjetrit.

Reagimet mbështetin nxënësit në ndërtimin e një pjesë të të mësuarit të qëndrueshëm. Mësuesi merr informacion me të cilat mund të vlerësojë njësinë. Si nxënësit edhe mësuesit mund të tërheqin idetë për planifikim të punës së tyre të ardhshme në EQD / EDNJ (lidhje me kapitull të tjera, zgjerime).

¹¹ Shih kapitullin në hyrjen e të mësuarit konstruktivist .

Materialet për mësuesit 3A

Katër qëndrime themelore politike



Pikëpamje liberale: liria e individit vjen e para

- Parimet kryesore: liria dhe përgjegjësia personale.
- Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe civile.
- Tregtia e lirë dhe konkurrenca si forcë lëvizëse e progresit, modernizimit dhe rritjes së mirëqenies.
- Kapitalizmi punon më mirë në qoftë se lihet i vetëm.
- Një shtet i fortë - por ai që kufizon veten në sundimin e ligjit.
- Përfitimet dorëlëshuara të sigurimeve shoqërore i bëjnë njerëzit dembel.
- Përpjekje personale dhe suksesi duhet të paguajnë – mos i tato të ardhurat dhe fitimet shumë rëndë.

Slogan: "Pa rrezik, nuk ka liri".



Pikëpamja social demokrate: barazia e parë

- Parimet kryesore: barazia, solidariteti, sigurimit social.
- Mbrojtja e të dobët, e të varfrit, e më pak të privilegjuarit.
- Nëse nuk është i kontrolluar, kapitalizmi do të thellojë ndarjen sociale. Nuk ka asnjë alternativë ndaj kapitalizmit, por pasojat e tij duhet të kontrollohen dhe të korrigjohen me mjete politike.
- Ne kemi nevojë për një sistem të sigurimeve shoqërore që të kujdeset për familjet, invalidët, të sëmurët, të moshuarit, të papunët dhe të varfrit.
- Solidariteti do të thotë i fuqishmi mbështet ata që kanë nevojë.

Slogan: "Të bashkuar ne qëndrojmë – të ndarë biem".



Pikëpamjet konservatore: Siguria e parë

- Parimet kryesore: siguria dhe stabiliteti.
- Një shtet i fortë është i rëndësishëm për mbrojtjen e vendit nga rreziqet dhe kërcënimet.
- Një shtet i fortë mbështetet në një ekonomi moderne, efikase.
- Thellimi i ndarjes shoqërore duhet të shmanget.
- Familja ka nevojë për mbrojtje të veçantë.
- Qytetarët duhet të kërkojnë mbështetje vetëm në se nuk mund të përballen të vetëm me problemet e tyre.

Slogan: "Një shtet i fortë në një ekonomi të shëndetshme".



Pikëpamja e të gjelbërve: Mjedisi natyror i pari

- Parimet kryesore: mbrojtja e mjedisit natyror, përgjegjësia për brezat e ardhshëm.
- Mënyra jonë e tanishme e jetës, e përshtatur për rritjen ekonomike dhe konsumin e karburanteve të fosileve, është një kërcënim serioz për të ardhmen tonë.
- Marrëveshjet ndërkombëtare janë të nevojshme për mbrojtjen e mjedisit në nivel global.
- Ne tregojmë përgjegjësi për brezat e ardhshëm dhe për të gjithë planetin.
- Ndryshimet e vogla në jetën tonë të përditshme mund të bëjnë ndryshimin.

Slogan: "Ju nuk mund të hani paratë".

Materiale për mësuesit 3B


Leksion: Cila është e mira e përbashkët?

Ky draft përshkruan udhëzimet bazë të analizës. Mësuesi duhet të përshtatë leksionin për nevojat mësimore të nxënësve dhe kontekstin e njësisë.

Në demokraci, është e kuptueshme se askush nuk e di me siguri se çfarë është e mira e përbashkët dhe ne, për këtë arsye, duhet të vendosim së bashku atë që ne e konsiderojmë të jetë më e mirë për komunitetin tonë. Në diktatura, regjimi vendos se çfarë është e mira e përbashkët - kjo është një nga dallimet e mëdha ndërmjet demokracisë dhe diktaturës.¹²

Çdokush mund të marrë pjesë në këtë diskutim të vazhdueshëm: partitë politike, grupet e interesit, mediat, politikanët dhe qytetarët si individë. Në thelb, kjo është ajo që quhet pjesëmarrja në demokraci – debati dhe në fund marrja e vendimit se çfarë është më e mira për vendin (ose për botën), dhe si të arrijmë këtë qëllim.

Ky kapitull është projektuar si një model i super thjeshtuar i këtij procesi vendimmarrës. Ju filloni duke sugjeruar idetë tuaja individuale për të mirën e përbashkët - kur ju mendoni për përparësitë tuaja, në qoftë se do të ishit udhëheqës i vendit tuaj, ju do të mendonit për të mirën e përbashkët. Tani ju jeni në mes të formimit të partive.



Në mësimin e ardhshëm, ju do të negocioni me njëri-tjetrin për të gjetur nëse ju mund të formoni një shumicë që përcakton të mirën e përbashkët - për momentin.

¹² Për më shumë detaje, shih fletët e punës së nxënësit

Kjo diagramë tregon se çfarë ndodh në një proces të tillë vendimmarrje. Supozoni se janë në diskutim dy qëllime themelore, qëllimi A dhe B (këto mund të lidhen me qëllimet konkrete që partitë kanë paraqitur). Tre Shigjetat me pika tregojnë zgjidhjen përfundimtare që partitë mbrojnë - disa do të donin t'i japin përparësi qëllimit A (variant AAB), të tjerët qëllimit B (varianti BBA). Këto janë idetë e ndryshme të kompromisit. Secila palë mbron një agjendë të caktuar që mbështet interesa të caktuara të grupit në shoqëri dhe kjo mundëson marrjen parasysh edhe të interesave të palës tjetër. Për këtë arsye, palët përpiqen të ndikojnë vendimmarrjen në drejtim të tyre - A1 dhe A2 në favor të qëllimit AAB, me partitë b1 dhe b2 që tërhiqen në drejtim të kundërt (BBA).

Cila alternativë është më e mira në drejtim të së mirës së përbashkët: AAB apo BBA? Apo është ndoshta balanca zhvendoset më shumë në mes: AB? Një vendim duhet të merret. Palët negociojnë, dhe përpiqen të gjejnë një kompromis për të cilin mund të bien dakord dhe, për këtë arsye, ta mbështetin së bashku. Në demokraci, kompromisi është çmimi që duhet paguar për pushtetin. Fuqia për të vendosur mbetet te shumica. Pakica apo individët, mund të ndikojnë vendimin përmes arsyetimit më të mirë.

Vendimet e marra në këtë mënyrë gjithmonë i nënshtrohen shqyrtimit kritik. Vendimi edhe mund të mos i shërbejë fare të mirës së përbashkët. Kushtet mund të ndryshojnë. Shumicat mund të ndryshojnë. Shumica mund të bindet, nga arsyetimi i mirë, të ndryshojë mendjen. Një komunitet demokratik është një komunitet që mëson.

Zgjerim (kjo pjesë mund të jepet edhe veç)

Si është e lidhur e gjitha kjo me konceptet kryesore të këtij kapitulli – me **diversitetin** dhe **pluralizmin**?

Duke ushtruar lirinë e tyre të mendimit dhe të shprehjes, qytetarët krijojnë një spektër të gjerë **diversiteti** të opinioneve individuale në atë që është më e mira për vendin. Qytetarët, të cilët janë të interesuar të shohim qëllimet e tyre të zbatuara në praktikë, bashkohen me organizata të tilla si partitë, grupet e interesit etj. Kjo është **pluralizëm** i organizuar (shih a1, a2, b1, b2 në diagramë).

Pluralizmi krijon konkurrencën për pushtet dhe ndikimin politik. Një vendim kërkon që disa qëllime dhe interesa të bëhen prioritet, ndërsa të tjerët refuzohen. Një kompromis është ndonjëherë i nevojshëm për të arritur një shumicë të mjaftueshme.

Qytetarët që nuk marrin pjesë në këtë lojë të shprehjes së interesave dhe pikëpamjeve të tyre qartë dhe me zë të lartë do ta gjejnë veten të lënë mënjanë. Është në interesin e kujtdo që të marrë pjesë në demokraci.

Materialet për mësuesit 3C

Sugjerime për zgjerime dhe detyra shtesë

1. Si i reflektojnë partitë ndasitë sociale?

Fletët e punës së nxënësit 3.5 dhe diskutime

- Çfarë ndasish ekzistojnë në shoqërinë tonë?
- Si i pasqyrojnë këto ndasi partitë në vendin tonë?
- Çfarë vendimesh dhe kompromisesh janë bërë?

2. Pluralizmi

- Çfarë grupesh interesi dhe OJQ-të janë të pranishme në politikë?
- Cilat interesat janë të organizuara më mirë? Cilat nuk janë?

3. Kompromisi

Në demokraci, pluralizmi gjeneron nevojën për kompromise. Për këtë ka pikëpamje të ndryshme:

1. Nga pikëvështrimi i lojtarit individual: kompromisi është çmimi që paguhet për pushtetin. Idetë e mira lihen mënjatë për një zgjidhje të dytë më të mirë.
2. Nga një pikëpamje e përgjithshme: pluralizmi gjeneron konkurrencë; lojtarët mbajnë njëri-tjetrin në kontroll dhe sigurojnë që asnjë prej tyre nuk bëhet shumë i fuqishëm. Pluralizmi në shoqëri ka të njëjtin efekt si bëjnë kontrollet dhe balancat në kushtetutë.
3. E parë nga këndvështrimi i prodhimit: Pluralizmi gjeneron nevojën për kompromis. Vendimet që shkojnë në ekstreme janë të rralla. Kjo mbështet kohezionin social.

- Cila nga këto pikëpamje konfirmohen nga realiteti në vendin tuaj, p.sh. një rast studimi?

4. Krahasimi i demokracisë dhe diktaturës

Fletët e punës së nxënësit 3.4

- Si i trajtojnë demokracitë dhe diktaturat interesat dhe pikëpamjet e ndryshme?
- Çfarë vendimesh merren? (Kriteri i krahasimit: përfshirja e interesave, efikasiteti, artikulum i kritikës, roli i mediave.)

5. Dy dimensionet e politikës

Max Weber:¹³

1. "Politika mund të krahasohet me hapjen e ngadalshme, por me pasion dhe gjykim të shëndoshë, të vrimave në një cope druri të trashë

2 "Kushdo që është aktiv në politikë përpiqet për pushtet."

- Si i përjetuam të dy dimensionet e politikës në këtë kapitull?
- Si i balancojnë aktorët e politikës këto dy dimensione në vendin tonë?

¹³ Max Weber, "Politics as a Vocation", pp. 2, 34 (www.sscnet.ucla.edu/polisci/ethos/Weber-vocation.pdf); quotations edited by the author.